



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurrenciju - Competition Authority

Vendimi Nr.13/24

Datë: 14.02.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 00.00.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga Kofola ČeskoSlovensko (blerës) dhe Moravská pivovarská (shitës) mbi Pivovary CZ Group a.s., dhe FONTÁNA PCZG s.r.o. (Ndërmarrje të Synuara).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55.1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë datë; 27.11.2023, me Nr. Prot. 567/23-11/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm nga Kofola ČeskoSlovensko (blerës) dhe Moravská pivovarská (shitës) mbi Pivovary CZ Group a.s., dhe FONTÁNA PCZG s.r.o.. (kompanitë e synuara)

Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 16.01.2024
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit, në web faqen e AKRK-së më datë 17.01.2024
3. Palët ne Përqendrim kanë lidhur Marrëveshje për Blerjen e Aksioneve, nënshkruar më 22.11.2023

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshjen lidhur mes palëve në Përqendrim për Blerjen e Aksioneve, nënshkruar më 22.11.2023.

Kofola ČeskoSlovensko a.s., është shoqëri aksionare me numër të regjistrimit të biznesit 24261980 dhe adresë të regjistruar në Nad Porubkou 2278/31a, Poruba, 708 00 Ostrava, Republika Çeke. Aktiviteti i Ndërmarrjes: merret me kontrollin dhe menaxhimin e aktiviteteve të biznesit të Kofola Group, kryesisht në prodhimin, shitjen me shumicë dhe shpërndarjen e pijeve joalkoolike.

Kofola ČeskoSlovensko është kreu i Grupit Kofola (Grupi Kofola). Aktivitetet e biznesit të Grupit Kofola konsistojnë kryesisht në prodhimin, shitjet me shumicë dhe shpërndarjen e pijeve joalkoolike në Evropën Qëndror dhe Lindore, kryesisht në Republikën Çeke, Sllovaki, Poloni, Slloveni dhe Kroaci, Aktivitetet e biznesit të Kofola ČeskoSlovensko, konsistojnë në kontrollin dhe menaxhimin e aktiviteteve të biznesit të Grupit Kofola,

SPV PIVOVARÝ TRIANGL, është kompani e kontrolluar nga Kofola, ČeskoSlovensko a.s, me zyrën e saj të regjistruar në Za Drahou 165/1, Pod Bezručovým vrchem, 794, Republika Çeke, 794, Krnov10. 198 83 218.

FONTÁNA PCZG s.r.o, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të regjistrimit të biznesit 19600151 dhe adresë të regjistruar në Komenského 3490/35, Přerov I-Město, 750 02 Přerov, Republika Çeke. Aktiviteti i ndërmarrjes është shitja me shumicë e një game të gjerë pësh alkoolike dhe jo alkoolike. Pijet alkoolike përfshijnë kryesisht birrën, ndërsa pijet joalkoolike përfshijnë ujëra pa arome dhe arome, lëngje, pije energjike, kola, tonik.

PCZG dhe Fontána (Kompanitë të synuara), PCZG është e angazhuar kryesisht në prodhimin dhe shitjen me shumicë të birrës, pije alkoolike dhe jo alkoolike, operon me birraritë Holba, Litovel dhe Zubr, të cilat prodhojnë birrë alkoolike dhe joalkoolike, birrë me arome, musht nën markën Z-limo, kola dhe pije të tjera joalkoolike të gazuara ("CSD").

Përpara zbatimit të transaksionit, ndërmarrjet e synuara janë 100% në pronësi të Moravská pivovarská a.s, me zyrën e saj të regjistruar në Komenského 3490/35, Přerov I-Město, 750 02 Přerov, Republika Çeke, ID Nr: 6476" (Moravská pivovarská").

Aksionari i vetëm i Moravská pivovarská është HSK Invest, a.s., me zyrën e saj të regjistruar në Václavská 316/12, Nové Město, 120 00 Prague 2, Republika Çeke, Nr. ID: 607 27 357 ("HSK Invest").

Tregu përkatës:

Tregu i produktit: prodhimi dhe shitja me shumicë e pijeve alkoolikë (Birra) dhe joalkoolike, (pije të gazuara, pije me aromë dhe pa aromë, lëngje, pije energjike, kola, dhe tonik).

Tregu gjeografik: në transaksionin e propozuar, është tregu ndërkombëtar, do të konsiderohet territori i Republikës së Çekisë.

Analiza e konkurrencës

Bazuar në të dhënat e ofruara nga aplikuesi i Njoftimit për Përqendrim, përkitazi me aktivitetin e prodhimit, shitjes me shumicë të pijeve alkoolikë dhe jo alkoolikë, i cili përkon kryesisht me tregun e Republikës Çeke, vlerësojmë se blerja si e tillë, nuk çon në mbivendosje horizontale apo marrëdhënie vertikale në aktivitetet e palëve, në Republikën e Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Njoftimi për Përqendrim, rrjedhimisht transaksioni do të realizohet, në Republikën Çeke. Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se, Kofola ČeskoSlovensko a.s., ka qarkullim në Kosovë përmes shitjeve, që përfaqësohet nga distributorë, sipas “Deklaratës” së palës, datë 22.11.2023, për shitjet e realizuara të Kofola Group në Kosovë. Kofola ČeskoSlovensko a.s., nuk ka filiale në Kosovë. Qarkullimi i Kofola Group, realizohet përmes filialit Sllloven RADENSKA d.o.o. në pronësi të plotë të Shoqërisë e cila, realizon shitjet përmes disa distributorëve që, përfaqësohet nga shitja me shumicë ndërkufitare të pijeve joalkoolike.

Prandaj shitja ndërkufitare me shumicë e pijeve joalkoolike të filialit të saj, Sllloven Radenska, sipas vlerësimit të përqendrimit, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës, në tregun përkatës.

Komisioni ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, të pjesëmarrësve, në përqendrim, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon në mënyrë direkte apo indirekte, me tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Kati i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net

KOMISIONI I KONKURENCËS

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare



III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva